

# Radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm Si mund të flasin nxënësit



Broshurë informuese  
për nxënësit



“ Ajo që mund të bëjmë  
më mirë është t’ju  
ndihmojmë juve ”

Kjo broshurë ofron këshilla praktike për t’ju  
ndihmuar të bisedoni me kolegët, mësuesit  
dhe familjarët tuaj për çështjet e radikalizmit  
dhe ekstremizmit të dhunshëm



# Përmbajtja

1. Si mund të flasim për radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm?..... 4
2. Çfarë është ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmi?..... 4
3. Si mund ta kuptoj se cili është një ekstremist i dhunshëm ose një terrorist? ..... 5
4. Cila është mosha më e mirë për të folur për radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm me prindërit dhe mësuesit?..... 6
5. Si mund të flas për veprime të dhunshme që lidhen me radikalizmin dhe ekstremizmin? ..... 7
6. A mund të shikoni fotografi ose video rreth akteve terroriste? ..... 7
7. Si mund të flisni për ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin pa krijuar stereotipe të dëmshme?..... 8
8. Ajo çfarë është e rëndësishme është që ti nuk do të jesh kurrë vetëm..... 9
9. Nëse unë kam shenja të ankthit të vazhdueshëm ose shqetësimit emocional, çfarë duhet të bëj? ..... 10

# 1.

## SI MUND TË FLASIM PËR RADIKALIZMIN DHE EKSTREMIZMIN E DHUNSHËM?

Le të jemi të sinqertë: aktet e dhunës për shkak të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm janë të frikshme, pavarësisht nëse ato ndodhin mijëra kilometra larg, ose brenda në komunitetet tona. Sa herë që ndodh një ngjarje tragjike, prindërit dhe mësuesit tuaj duan të dinë se si t'ua shpjegojnë juve veprime të tilla ekstreme. Kjo krijon një mëdyshje - si është e mundur që ju të forconi ndjenjën tuaj të sigurisë ndërsa merrni përgjigje të sinqerta për pyetjet që keni në lidhje me këtë lloj dhune brenda shoqërisë sonë.

### SI KALOHEM NGA RADIKALIZMI DREJT DHUNËS?

Radikalizimi që çon në dhunë është një proces në të cilin individët adoptojnë një sistem besimesh ekstreme - përfshirë bindjen për të inkurajuar, lehtësuar ose përdorur dhunën - me qëllim që të arrihet transformimi shoqëror duke imponuar një ideologji, projekt politik ose kauzë të caktuar.

### TA THEMI MË THJESHT

Radikalizimi i dhunshëm është kur një person beson se për të përmbushur një ide ose një synim që është i rëndësishëm për të, ai/ajo ka të drejtë të nxisë ose të përdorë dhunën për të imponuar atë ide.

# 2.

## ÇFARË ËSHTË EKSTREMIZMI I DHUNSHËM DHE TERRORIZMI?

### EKSTREMIZMI I DHUNSHËM

Ekstremizmi është kur dikush merr një pozicion - mbi identitetin, kulturën, shoqërinë, besimin fetar ose politikën - që është ekstrem në krahasim me spektrin e zakonshëm të besimeve në një shoqëri. Një ekstremizëm i tillë bëhet i dhunshëm kur mjetet e dhunshme përdoren për të mbrojtur ose promovuar këtë pozicion. Ekstremizmi i dhunshëm përfshin terrorizmin, por edhe çdo akt tjetër të urrejtjes përçarëse, ose të dhunshme, të nxitur nga motive ideologjike, fetare, politike etj.

## TERRORIZIMI?

Terrorizmi nënkupton një strategji të akteve të dhunshme të ndërmarra për të krijuar frikë, panik, pasiguri tek popullata ose për të bërë presion ndaj një qeverie në mënyrë që të tërheqë vëmendjen ndaj kërkesave politike, ideologjike, kulturore, fetare ose shoqërore. Terrorizmi është një shfaqje dhe rezultat përfundimtar i ekstremizmit të dhunshëm; ai shpesh organizohet dhe promovohet nga grupe ekstremiste me qëllim që të detyrojë një shoqëri ose qeveri të marrë vendime ose të miratojë orientime që ato nuk do të zgjidhnin ndryshe t'i zbatonin.

## TA THEMI MË THJESHT

EKSTREMIZMI I DHUNSHËM është kur një person mbështet dhe mbron mendime ekstreme që janë në kundërshtim me interesat më të mira të komunitetit në tërësi. Në shumë raste, persona të tillë nxisin ose përdorin dhunën për të imponuar idetë e tyre.

TERRORIZMI është një akt i krijimit të frikës nëpërmjet përdorimit të dhunës duke sulmuar mënyrën e jetës dhe liritë e njerëzve të pafajshëm për të imponuar ide dhe besime ekstreme.

### 3.

## SI MUND TA KUPTOJ SE CILI ËSHTË NJË EKSTREMIST I DHUNSHËM OSE TERRORIST?

Ajo që ju do të kuptoni ndryshon në varësi të moshës, temperamentit dhe personalitetit tuaj. Nuk ka “asnjë masë që iu përshtatet të gjithëve». Në moshë të caktuar, apo në nxënës të caktuar, këto fenomene kuptohen ndryshe.

- *Për fëmijët e vegjël, për shembull: “Ekstremizmi është kur dikush bën diçka të keqe dhe mendon se ka një arsye të dobishme për ta bërë atë. Por përdor mënyra më paqësore për të përçuar mesazhin tek ata.”*
- *Nëse ju jeni në një moshë më të madhe, ju mund të kuptoni një koncept më të ndërlikuar, por prapëseprapë ju do t'i kuptoni shkaqet dhe motivet e këtyre fenomeneve bazuar në aftësitë tuaja në varësi të edukimit dhe moshës tuaj.*

Nëse ju nuk keni dëgjuar për ekstremizmin e dhunshëm, terrorizmin, ose ngjarjet e ngjashme, këto diskutime me mësues mund t'ju bëni në një kohë më të përshtatshme. Nëse ju keni dëgjuar rreth këtyre fenomeneve, flisni me prindërit, mësuesit apo moshatarët tuaj në mënyrë që ta kapërceni frikën që ju keni.

Është e rëndësishme që pas çdo diskutimi për këto tema të qëndroni i qetë dhe të mos trembeni.

## ÇFARË ËSHTË NJË TERRORIST?

Terroristët, ose ekstremistët e dhunshëm, janë njerëz që duan të bindin të tjerët se idetë e tyre janë të drejta dhe që përdorin dhunën për t'i realizuar apo arritur ato.

- *Shumica e njerëzve nuk veprojnë në këtë mënyrë dhe se situata të tilla janë të rralla.*
- *“Njerëzit zakonisht nuk përpiqen t'i bindin të tjerët duke përdorur dhunë. Kjo gjë ndodh rrallë.”*
- *Vetëm një numër shumë i vogël njerëzish janë në të vërtetë ekstremistë dhe terroristë të dhunshëm. Është e vërtetë që ne flasim shumë për ta në lajme dhe TV, dhe kjo të krijon përshtypjen se ka më shumë prej tyre se sa janë me të vërtetë.*
- *“Ka vetëm disa terroristë”.*
- *“Dhe ata nuk janë kudo.”*

Është e rëndësishme të kuptoni rëndësinë e mbrojtjes së ideve tuaja dhe respektimit të të tjerëve, atyre që nuk pajtohen me ju. Gjithashtu është e rëndësishme të përcaktoni mënyrat paqësore të zgjidhjes së konflikteve ose dallimeve.

# 4.

## CILAËSHTË MOSHAMË E MIRË PËRTË FOLUR PËR RADIKALIZMIN DHE EKSTREMIZMIN E DHUNSHËM ME PRINDËRIT DHE MËSUESIT?

### DISKUTIMI

Ju mund të diskutoni mbi problemin e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit në një moshë mjaft të hershme nëse i kuptoni këto fenomene. Por është e rëndësishme të mos i diskutoni këto çështje, nëse nuk jeni gati, në mënyrë që të mos krijoni frikë ose ankth.

Merrni parasysh moshën tuaj, natyrën e pyetjeve që ju shqetësojnë, si dhe nevojën tuaj për të kuptuar ose shprehur diçka për fenomenin.

5.

## SI MUND TË FLAS PËR VEPRIME TË DHUNSHME QË LIDHEN ME RADIKALIZMIN DHE EKSTREMIZMIN?

Së pari, duhet një atmosferë e sigurt në mënyrë që ju të shprehni emocionet dhe frikën tuaj rreth situatës.

**PYETJET QË MUND T’IU BËJNË MË SHPESH TË RRITURIT NË LIDHJE ME EKSTREMIZMIN E DHUNSHËM DHE RADIKALIZMIN.**

*“Si ndihesh?”*

*“Çfarë mendoni për atë që po ndodh?”*

*“A jeni i/e shqetësuar?”*

Është e rëndësishme të kuptoni se çfarë dini ju rreth ekstremizmit të dhunshëm dhe nga ju vjen informacioni për të.

Ju duhet të kuptoni se kur ballafaqohemi me ngjarje të shkaktuara nga radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm është normale të kemi mendime dhe ndjenja për të.

6.

## A MUND TË SHIKONI FOTOGRAFI OSE VIDEO RRETH AKTEVE TERRORISTE?

Fotografitë ose videot e akteve terroriste, qofshin të dhunshme apo jo, mund të krijojnë ankth dhe makth për ju, veçanërisht kur jeni në moshë shumë të vogël.

Rekomandohet që ta shmangni ekspozimin e vetes tuaj ndaj këtyre imazheve ose lajmesh të përsëritura. Ata mund t’ju krijojnë përshtypjen se e gjithë bota është bërë e tmerrshme dhe shqetësuese.

Sidoqoftë, nëse keni parë pamje të tilla, përpiquni të kuptoni se çfarë po kaloni dhe flisni me familjarët tuaj apo më të rriturit për atë që keni parë dhe çfarë ndjeni.

Nëse ju nuk dëshironi të flisni për tema të tilla, ia shprehni këtë mendim të rriturve që ju rrethojnë.

Për më tepër, nëse ju dhe familjarët tuaj po shikoni TV që përshkruan akte terroriste, sigurohuni që ju ndieheni mirë dhe që jeni në gjendje të vazhdoni shikimin e materialit që transmetohet.

Edhe nëse ju mendoni se jeni në rregull, ju mund t'u kërkonti të afërmeve tuaj t'ju ndihmojnë në interpretimin e informacionit duke shtuar detaje, nëse është e nevojshme, dhe gjithmonë në një mënyrë të qetë.

Ju gjithashtu mund t'u sugjeroni prindërve tuaj që të ndryshojnë kanalin duke thënë: *«Ne kemi dëgjuar mjaft për dhunën, por kjo nuk është e vetmja gjë që po ndodh në botë dhe ajo po merr shumë kohë.»*

Mos harroni se kur ka një akt dhune, prindërit në familje dhe mësuesit në shkollë, janë personat ku ju mund të drejtoheni për të mësuar se çfarë po ndodh dhe të siguroheni për shëndetin tuaj. Është një mundësi për një bisedë të qetë për situatën dhe një shans për të korrigjuar çdo informacion të gabuar që ju mund të keni parë, dëgjuar apo lexuar.

## 7.

### **MUND TË FLISNI PËR EKSTREMIZMIN E DHUNSHËM DHE TERRORIZMIN, PA KRIJUAR STEREOTIPE TË DËMSHME?**

Në fakt, vetëm disa individë ekstremistë qëndrojnë prapa dhunës, pavarësisht se në çfarë forme ajo shfaqet. Dhuna mund të lidhet me shkaqe të ndryshme, ose me motivime ideologjike. Dikush mund t'i përmbahet një ideologjie pa qenë i dhunshëm, sikurse një anëtar i një grupi mund të përdorë dhunën për të promovuar këtë ideologji, pa anëtarët e tjerë të grupit që e aprovojnë ose marrin pjesë në dhunë.

Ekstremizmi i dhunshëm (ose terrorizmi) është një dukuri shoqërore që nuk ka asnjë lidhje me ndonjë komunitet, grup apo fe të veçantë.

Kjo është e rëndësishme për të parandaluar përhapjen e paragjykitimeve që mund t'ju bëjnë juve që të keni frikë nga grupe ose komunitete të caktuara.

“Ka njerëz të këqij në të gjitha fetë, por ka besimtarë të tyre që gjithashtu janë njerëz shumë më të mirë.”



“Vetëm sepse dikush bën diçka të gabuar, nuk do të thotë se i gjithë komuniteti është si ai. Nëse dikush vjedh diçka, ne e dimë se nuk do të thotë se çdo banor i atij qyteti është një hajdut.”

## 8.

## AJO ÇFARË ËSHTË E RËNDËSISHME ËSHTË QË TI NUK DO TË JESH KURRË VETËM

### NJË PYETJE E MUNDSHME

“Mund të më ndodhë mua, mamasë dhe babait tim, familjes time?”

### NJË PËRGJIGJE E MUNDSHME

“Gjëra të tilla janë shumë të rralla.” “Është e tmerrshme ajo që ndodhi, por fatmirësisht nuk ndodh shpesh.”

### MIRËQENIA JUAJ

Është e rëndësishme që deri në fund të bisedës me më të rriturit ose profesionistët, ju personalisht të ndjeheni të sigurt dhe të mos ndjeni ankth apo frikë. Nëse ju kenë nevojë që persona të tjerë të rrinë afër me ju sepse nuk ndiheni i qetë, kërkojeni këtë gjë.

### BESIMI JUAJ

Në fund të fundit, është e rëndësishme që ju ta perceptoni botën dhe shoqërinë si një vend të sigurt, ku shumica e njerëzve nuk janë kërcënim.

Ka shumë njerëz në mbarë botën që janë duke bërë shumë gjëra të mira, gjithashtu janë duke ndodhur dhe gjëra shumë të dobishme, dhe që po e bëjnë botën çdo ditë një vend më të mirë, si në komunitetin tuaj, edhe në vendet e tjera.

Pas ngjarjeve të tilla rrini me të afërmit tuaj, shokët/shoqet, me mësuesit, etj. dhe vazhdoni normalisht veprimtaritë tuaja të përditshme me qetësi.

# 9.

## NËSE UNË KAM SHENJA TË ANKTHIT TË VAZHDUESHËM OSE SHQETËSIMIT EMOCIONAL, ÇFARË DUHET TË BËJ?

Ju fëmijët reagoni ndryshe ndaj veprimeve që lidhen me radikalizimin e dhunshëm dhe ekstremizmin, dhe disa prej jush preken më shumë se të tjerët.

Është e rëndësishme t'i kushtoni vëmendje sjelljes dhe simptomave fizike që ju kenë, kështu që të mund të identifikoni ndonjë shenjë ankthi ose shqetësimi emocional. Jini të vetëdijshëm se shenja të tilla nuk janë ekskluzive ndaj ekspozimit ndaj mbulimit mediatic të radikalizimit të dhunshëm dhe ekstremizmit.

Nëse simptomat vazhdojnë, mendoni të kërkonti ndihmë profesionale, të flisni me më të rriturit ose familjarët tuaj.

Mos harroni se ju nuk i shprehni emocionet tuaja në të njëjtën mënyrë siç bëjnë të rriturit!

Nëse mendoni se po përjetoni ankth, flisni me më të rriturit, kërkojuni atyre që t'ju ndihmojnë që të ndiheni të sigurt, të mbrojtur, dhe t'ju qëndrojnë afër. Më të rriturit kanë përparësi t'ju ndihmojnë juve që të përballoni ndjenjat e shkaktuara nga situatat shqetësuese.

SJELLJA	SIMPTOMAT FIZIKE	PROBLEMET E GJUMIT
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Axhitim i pazakontë</li> <li>• Ankth i dukshëm</li> <li>• Reagime agresive</li> <li>• Izolim</li> <li>• Regres</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dhimbje koke</li> <li>• Dhimbje stomaku</li> <li>• Humbje e oreksit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Makthe të përsëritura</li> <li>• Probleme me gjumin</li> <li>• Refuzim për të shkuar në shtrat</li> <li>• Dëshirë të flejë me një prind</li> </ul>

## **PSE DUHET QË TË KONTAKTOJ QENDRËN E KOORDINIMIT KUNDËR EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM (CVE)?**

CVE ka një ekip profesionistësh, detyra kryesore e të cilëve është të sigurojë trajnimin, mbështetjen dhe ndihmën psiko-sociale që ju nevojitet për të adresuar radikalizmin. Nëse është e nevojshme, ne gjithashtu mund t'ju drejtojmë tek shërbime dhe burime të tjera brenda komunitetit.

- **Burime:**

<https://cve.gov.al/>

Do të gjeni materiale burimore të nevojshme.

- **Disa shërbime**

Qëllimi kryesor i ekipit tonë është t'ju ofrojë mbështetje

- **Mjete të specializuara**

Për të kuptuar më mirë të gjitha aspektet e radikalizmit

- **Ndihma është e disponueshme 24/7**

Qendra Kombëtare e Urgjencës

<http://urgjenca.gov.al/>

112

**Policia e Shtetit**

129





Ky material është botuar në  
kuadër të projektit  
“Parandalimi i radikalizmit dhe ekstremizmit  
të dhunshëm në shkolla dhe komunitete si mjet për  
garantimin e të drejtave të fëmijëve”,  
i financuar/mbështetur nga **UNICEF** dhe zbatuar nga  
**Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm,  
Ministria e Arsimit Rinisë dhe Sporteve dhe Save the Children.**

@Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret apo kopjohet lirisht prej  
specialistëve të fushës, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht që çdo  
riprodhim të shoqërohet me njohjen e organizatave,  
të përmendura më lart, si burim.

Këndvështrimet e autorëve të këtij botimi jo domosdoshmërisht  
pasqyrojnë pikëpamjet e Save the Children dhe UNICEF.



Tiranë, 2020